



Të rinjtë, politika dhe administrata publike

RAPORT MONITORIMI

Shkurt - Prill 2023

QENDRESA
QYTETARE



NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
RENIS META

Tabela e përmbajtjes

1. Analiza e kontekstit
2. Metodologjia dhe të dhënat demografike
3. Analiza e detajuar e të dhënave të sondazhit
4. Gjetjet kryesore
5. Rekomandime
6. Referenca



1. Analiza e kontekstit

Në Shqipëri, depolitizimi i administratës publike nuk është vetëm një standard që duhet përmbushur, por një sfidë themelore për përmirësimin e funksionimit të administratës publike.

Administrata Publike në Shqipëri është në një tranzicion të vazhdueshëm dhe vazhdon të jetë vulnerabël nga ndikimi i politikës dhe nga ndryshimet e vazhdueshme të pushtetit. Influenca e vazhdueshme e politikës mbetet arsyeja prapa problematikave që mbizotërojnë në administratën publike (Dhëmbó.E, 2014, f.46, 47).¹

Nga sondazhi kombëtar "Besimi në qeverisje" për vitin 2021, ka rezultuar se pesë institucionet që perceptohen nga publiku si më të korruptuarat ishin gjyqësori, ndjekur nga institucionet e kujdesit shëndetësor dhe administrata publike (IDM, 2022, f.8).²

Një administratë publike transparente dhe funksionale është parakusht për qeverisje demokratike transparente dhe efektive. Administrata publike është në themel të funksionimit të shtetit, dhe reflekton aftësinë dhe vullnetin e qeverisë për të ofruar shërbime publike cilësore.

Një nga sfidat kryesore për Shqipërinë mbetet zhvillimi i institucioneve të përgjegjshme dhe transparente që ofrojnë shërbime publike efektive. Institucione publike, me individë të cilët janë punësuar në bazë të lidhjeve politike, korrupsionit, apo nepotizmit e jo me meritë, rezultojnë në shërbime dhe infrastrukturë publike me cilësi të dobët, duke cënuar kështu legjitimitetin e institucioneve publike dhe ulur besimin në publik.

Të dhënat e gjeneruara nga anketa e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor tregojnë që në përgjithësi qytetarët e konsiderojnë punësimin në institucionet publike dhe ato të sigurisë jo të drejtë dhe të pabazuar në meritë. Rreth 40.03% e qytetarëve konsiderojnë punësimin në administratën publike të bazuar në lidhje politike dhe nepotizmin si mënyrat më të përdorura për punësim në administratë.³

Administrata publike luan rol thelbësor në procesin e integritimit evropian duke qenë në front të parë të zbatimit të reformave thelbësore dhe dialogut të anëtarësimit me Bashkimin Evropian (BE). Në Strategjinë e Zgjerimit 2018, Komisioni Evropian (2018) rivendosi edhe njëherë rëndësinë mbi reformën e administratës publike si një nga tre fushat "prioritare" të procesit të zgjerimit të BE-së: "Adresimi i reformave në fushën e sundimit të ligjit, të drejtave themelore dhe

¹ Dhëmbó.E. (2014). Shqiptarët dhe Modeli Social Evropian. Administrata Publike në Shqipëri Midis Politikës dhe Qytetarit.

² Semini.I & Korçari.I. (2022). Sondazh i opinionit publik 2021: Besimi në qeverisje. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). <https://idmalbania.org/public-opinion-poll-trust-in-governance-2021/>

³ Hallunaj.M & Strati.N. (2023). Perceptimi publik ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, se dhe çështjeve të korrupsionit në Shqipëri. Anketa e WBSB në Shqipëri. Barometri i Sigurisë. Raporti i Shteti 2023.



qeverisja e mirë mbetet çështja më urgjente për Ballkanin Perëndimor”.

Komisioni European në progres raportin e fundit për Shqipërinë, ka konstatuar se Shqipëria ka ende punë për të bërë në rekrutimin e bazuar në meritokraci, si dhe promovimi dhe shkarkimi e punonjësve në administratën publike duhet të konsolidohet duke përdorur standartet e nevojshme. Po ashtu, raporti i Komisionit European vë në dukje se mekanizmat e monitorimit të administratës publike mbeten joefektive dhe të brishta (Komisioni European, 2022, fq.15, 23).⁴

Komisioni European (2022) ka vendosur edhe njëherë theksin në rekomandimet e raportit të vitit 2021, ku duket se Shqipëria ende nuk i ka përmbushur rekomandimet dhe nuk ka progresuar mjaftueshëm, ku veçanërisht kërkohet zbatimi efektiv i dispozitave për rekrutimin e bazuar në merita dhe në ligjin e shërbimit civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelet drejtuese (fq. 13-15).

Mungesa e besimit në institucionet e vendit dhe administratën publike mbetet një prej arsyeve kryesore që i shtyn të rinjtë shqiptar të lënë vendin. Zhgënjimi dhe frustrimi i të rinjve që zgjedhin të lënë vendin, vjen kryesisht për shkak të korrupsionit, nepotizmit, promovimit në bazë të kriterëve jo profesionale, mungesës së meritokracisë dhe vlerësimit të tyre. Papunësia e të rinjve vijon të mbetet një nga arsyet thelbësore për largimin e tyre nga vendi, pasi janë pikërisht të rinjtë e diplomuar ata që vuajnë nivelet më të larta të papunësisë. Sfidat bëhen më të dukshme kur të rinjtë hasin vështirësi për gjetjen e një pune për shkak të korrupsionit dhe nepotizmit, pamundësisë për të përparuar në karrierën e tyre në bazë të aftësive dhe kualifikimeve, si dhe mungesës së sigurisë në punë, të ndikuar nga përkatësia politike (partiake) dhe ndryshimet qeveritare (King.R dhe Gëdeshi.I., 2020, f.57).⁵ Ajo çfarë është edhe më shqetësuese është se të rinjtë po shfaqin gjithmonë e më tepër shenja të pranimit dhe të tolerimit të praktikave jologjore dhe jolegjitime, sidomos për të zgjidhur çështje personale dhe për të gjetur një punë (FES, 2019, f.17, f.20).

⁴ Komisioni European (KE). (2022). Progres raporti për Shqipërinë 2022.

⁵ King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?



2. Metodologjia dhe të dhënat demografike

Qëllimi i studimit

Të dhënat e INSTAT tregojnë se rritja e numrit të të punësuarve në administratën publike filloi në vitin 2018, ndërsa rritja më e madhe u krye gjatë tremujorit të katërt të vitit të kaluar, periudhë që përkon edhe me vitin zgjedhor. Shqipëria ka pasur një numër kaq të lartë të punësuarish në Administratën Publike në vitin e largët 2002, dhe gjatë këtyre viteve nuk ka pasur një rritje të numrit të të punësuarve deri në vitin 2017, kur filloja fryrja e administratës publike dhe institucioneve të tjera publike.

Ndikimi dhe ndërhyrjet e vazhdueshme në administratën publike dhe shfrytëzimi i saj për kapital politik, veçanërisht gjatë zgjedhjeve çënon besimin në institucionet e vendit. Klasa politike e ka përdorur jo pak herë punësimin për të vjelur vota dhe përftuar kapital politik, veçanërisht kjo praktikë korruptive ka gjetur vend tek të rinjtë, ku në sajë të premtimeve për punësim një pjesë e madhe e të rinjve shqiptar e gjejnë veten të përfshirë në struktura partiake.

Ajo çfarë është edhe më shqetësuese është se të rinjtë po shfaqin gjithmonë e më tepër shenja të pranimit dhe të tolerimit të praktikave joligjore dhe jolegjitime, sidomos për të zgjidhur çështje personale dhe për të gjetur një punë apo për tu promovuar në karrierën e tyre (FES, 2019).

Ndaj, Qëndresa Qytetare duke marrë në konsideratë nevojën për të trajtuar këtë problem strukturor të rrënjosur dhe shtrirë kudo në Shqipëri, ka ndërmarë këtë studim për të matur perceptimin që kanë të rinjtë për ndikimin që ka politika në administratën publike sipas tyre.

Metodologjia kërkimore e përdorur

Studimi është realizuar nëpërmjet një sondazhi të publikuar online. Forma e realizimit të pyetësorit u mundësua nëpërmjet softuerit të administrimit të sondazheve "Google Form" duke u mbështetur nëpërmjet platformës Facebook Ads. Pyetësori nuk u publikua në rrjetet sociale apo Facebook, me qëllim shmangien apo minimizimin në maksimum të mundësisë së plotësisimit së pyetësorit më shumë se një herë nga i njëjti individ apo mundësinë e shpërndarjes në grupe të cilat ndajnë qëndrime të unifikuara për çështjen.

Për të siguruar gjithëpërfshirje, shpërndarje të drejtë dhe plotësim vetëm nga të rinjtë, pyetësori u kushtëzua të shfaqej në mënyrë rastësore vetëm për të rinjtë e moshave 16-29 vjeç në të gjitha fashat orare. Pyetësori u hartua dhe pilotua para se të finalizohet duke u bazuar në literaturë dhe instrumente të aplikuara më parë në studime të ngjashme.

Popullata e studimit ishin të rinjtë e grupmoshës 16 – 29 vjeç dhe 308 të rinj u përfshinë në studim.




Studimi është realizuar në një shkallë të vogël, si dhe, metoda kërkimore e përdorur mbart një sërë kufizimesh, ndaj dhe gjerëzimi i të dhënave mbetet i limituar.

Analiza e të dhënave

Analizimi i të dhënave u bë duke u bazuar në metodën e statistikës deskriptive (përshkruese). Për të përshkruar, vlerësuar dhe interpretuar të dhënat e disponueshme në këtë studim u përdorën disa tregues dhe paraqitja grafike. Kështu, duke qenë se në studim kishim të bënim kryesisht me variabla kategorike atëherë u përdorën teknikat përshkruese dhe analizuese të përshtatshme për këto lloj variablash. Përshkrimi i të dhënave me statistikën deskriptive është një metodë e vlefshme për të kuptuar dhe vlerësuar një grup të dhënash të disponueshme. Përmes kësaj metode, mund të identifikohen karakteristikat kryesore të të dhënave.

Karakteristikat demografike të kampionit përfundimtar prej 308 individësh janë paraqitur më poshtë në lidhje me moshën, shpërndarjen gjinore dhe angazhimin/punësimin e tyre si dhe përfshirjen në forumet rinore politike.


Mosha e të rinjve të përfshirë në studim varionte nga 1.9% për grupmoshën 14-18 vjeç, 56.7% për grupmoshën 19-23 vjeç, si dhe 56.7% e të anketuarëve ishin 24 - 29 vjeç. Në total, popullata e kampionit përfundimtar përfshiu 57.2% femra dhe 42.8% meshkuj.



Rreth 31% e të anketuarve të përfshirë në studim janë student, 31.3% janë të punësuar në sektorin privat, 24.5% janë pjesë e administratës publike, 13% janë të papunësuar.




Angazhimi apo Punësimi:



75.5% e të rinjve që u bënë pjesë e anketimit nuk kanë qenë ndonjëherë pjesë e strukturave rinore të partive politike apo në lëvizje politike, 20.2% e të rinjve kanë pohuar se kanë qenë pjesë e këtyre strukturave, si dhe 4.3% e tyre kanë refuzuar të përgjigjen.

A keni qenë ndonjëherë pjesë e strukturave rinore të partive politike (Forumeve Rinore Politike)?




3. Analiza e detajuar e të dhënave të sondazhit

84.6% e të rinjve kanë pohuar se për tu bërë pjesë e administratës publike është më e lehtë nëse je i angazhuar si i ri në forumet rinore politike apo strukturat partiake, 10.6% e të rinjve kanë pohuar se përfshirja në forumet rinore politike nuk e bën më të lehtë punësimin në administratën publike dhe 4.8% kanë refuzuar të përgjigjen.




Për tu bërë pjesë e administratës publike është më e lehtë nëse je i angazhuar si i ri në forumet rinore politike apo strukturat partiake?




Sa i takon opinionit që të rinjtë kanë për rëndësinë që kanë njohjet me njerëzit në politikë apo pushtet që një i ri të punësohet në Administratën publike, 72.1% e tyre janë shprehur se këto njohje janë shumë të rëndësishme, 15.9% e të rinjve pohojnë se janë të rëndësishme, 8.2% e tyre mendojnë se janë deri diku të rëndësishme, 2.4% i shohin si jo të rëndësishme, si dhe 1.4% e tyre mendojnë se nuk janë aspak të rëndësishme.

Në anën tjetër, sa i takon perceptimit të të rinjve mbi nepotizmin, 74.5% e të rinjve shprehen se njohjet apo lidhjet familjare për një të ri, që të punësohet në Administratën Publike janë shumë të rëndësishme, 16.3% e të rinjve i konsiderojnë të rëndësishme, 5.3% i shohin si të rëndësishme deri në një farë mase, 2.4% mendojnë se janë jo të rëndësishme, si dhe 1.4% e tyre mendojnë se nuk janë aspak të rëndësishme.

Njohjet me njerëzit në politikë apo pushtet




Njohjet (Nepotizmi/lidhjet familjare)




Të rinjtë janë pyetur se deri në çfarë mase mendojnë se ndërhyrjet politike e kanë prekur Administratën Publike dhe 70.7% e tyre mendojnë se administrata publike është *tërësisht e kapur nga politika*, 25.5% e të rinjve mendojnë se administrata publike është *pjesërisht e kapur nga politika*, 1.0% mendojnë se administrata publike *nuk është aspak e ndikuar apo kapur nga politika* dhe 2.9% kanë refuzuar të përgjigjen.

Deri në çfarë mase ju mendoni se ndërhyrjet politike (partiake) kanë prekur Administratën Publike?



Kur të rinjtë janë pyetur mbi ndikimin që ka paqëndrueshmëria në skenën politike, veçanërisht në gjatë zgjedhjeve, ndikon në Administratën Publike, 63.9% e të rinjve janë shprehur se janë *shumë dakord* me pohimin, 23.1% *bien dakord me pohimin*, 10.1% janë *deri diku dakord*, 1.4% pohojnë *nuk janë dakord me këtë pohim*, si dhe 1.4% e tyre *nuk janë aspak dakord* se paqëndrueshmëria politike ndikon administratën publike.


Paqëndrueshmëria politike ndikon administratën publike.



Të rinjve i është kërkuar mendimi nëse ndërhyrjet apo influenca e vazhdueshme e politikës ndikojnë në efikasitetin dhe cilësinë e punës së administratës publike, 56.3% e të rinjve mendojnë se ndërhyrjet që ndodhin në administratën publike *ndikojnë shumë* në mbarëvajtjen e punës dhe efikasitetin e administratës publike, 22.1% mendojnë se *ndikojnë*, 16.8% mendojnë se ndërhyrjet politike *ndikojnë deri në një farë mase*, 1.9% mendojnë se *nuk e ndikojnë* dhe 2.9% mendojnë se *nuk e ndikojnë aspak*.



A mendoni se ndërhyrjet politike/partiake ndikojnë në efijencën e Administratës Publike?



Të rinjtë janë pyetur nëse politika ka shtrirë ndikimin e saj në vitet e fundit në administratën publike, ndikim që përkon dhe me rritjen e numrit të punonjësve në administratën publike sipas të dhënave të fundit të INSTAT, 68.3% e të rinjve janë shprehur se në pesë vitet e fundit politika ka shtrirë ndikimin e saj edhe më tepër në administratën publike, 18.8% shprehen se ka të njëjtin ndikim si më parë, 3.8% vlerësojnë se ndikimi i politikës në Administratën Publike ka rënë, si dhe 9.1% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen.


Si e vlerësoni ndikimin e politikës në Administratën Publike në 5 vitet e fundit?



Të rinjtë u pyetën mbi mënyrën se si përzgjidhen punonjësit e administratës publike, 64.4% e tyre mendojnë se personat e punësuar në administratën publike janë më së shumti të punësuar përmes lidhjeve politike, 12% mendojnë nepotizmi, 12.5% korrupsioni, 4.8% mendojnë se përzgjedhja ndodh bazuar në merita si dhe 6.3% e të anketuarve nuk kanë pasur një mendim mbi këtë çështje.




Sipas mendimit tuaj, personat e punësuar në Administratën publike janë më së shumti të punësuar sipas:



Kur të rinjtë janë pyetur nëse kanë besim në punën e Administratës Publike, 25.5% janë shprehur se nuk kanë aspak besim, 29.3% e tyre janë përgjigjur se nuk kanë besim, 35.1% kanë besim deri në një farë mase, 7.7% kanë besim, dhe 2.4% janë përgjigjur se kanë besim plotësisht.


Ju si një e re/ri, a keni besim në punën e Administratës Publike në Shqipëri?



53.8% e të rinjve e kanë vlerësuar negativisht punën e bërë nga Departamenti Administratës Publike (DAP) për të minimizuar apo shmangur ndërhyrjet politike (partiake) dhe garantimin e të drejtave të barabarta në punësim, 18.8% e kanë vlerësuar pozitivisht, si dhe 27.4% janë përgjigjur se nuk kanë informacion mbi këtë çështje.




Si e vlerësoni punën e bërë nga (DAP) për të minimizuar apo shmangur ndërhyrjet politike (partiake) dhe garantimin e të drejtave të barabarta në punësim?




Të rinjve u pyetën nëse në të ardhmen politika do ta ulë ndikimin që ka në administratën publike dhe nuk do ta përdorë si një mjet për të shtrirë dhe shfrytëzuar pushtetin. 71.2% e të rinjve nuk besojnë se politika do ta ulë ndikimin që ka në administratën publike në të ardhmen, 13.9% besojnë se politika do ta ulë ndikimin e saj, 14.9% e tyre janë shprehur se nuk kanë një opinion për të ndarë.

A besoni se politika do ta ulë ndikimin që ka në Administratën Publike në të ardhmen?



Kur të rinjtë u pyetën nëse në të ardhmen e afërt do ta konsideronin anëtarësimin në një parti politike për të rritur mundësitë e tyre të punësimit në administratën publike, 53.4% e të rinjve nuk do ta konsideronin, 25.5% kanë pohur se ndoshta do ta konsideronin përfshirjen në një parti politike për të rritur shanset e tyre për punësim, 11.1% e tyre do ta konsideronin, si dhe 10.1% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen.

A do ta konsideronit në të ardhmen anëtarësimin në një parti politike për të rritur mundësitë tuaja për tu punësuar në Administratën Publike?



4. Gjetjet kryesore

- Rreth 85% e të rinjve mendojnë se angazhimi në forumet rinore politike apo strukturat partiake e bën më të lehtë punësimin në administratën publike.
- 72% e të rinjve mendojnë se njohjet me njerëzit në politikë apo pushtet janë shumë të rëndësishme për një të ri të punësohet në administratën publike dhe rreth 16% e të rinjve pohojnë se janë të rëndësishme.
- 74.5% e të rinjve besojnë se njohjet apo lidhjet familjare janë shumë të rëndësishme që një i ri të punësohet në Administratën Publike dhe 16.3% e të rinjve i konsiderojnë të rëndësishme.
- Perceptimi se ndërhyrjet politike e kanë prekur thellësisht administratën publike tek të rinjtë rezulton në përqindje të lartë, ku 70.7% e të rinjve mendojnë se administrata publike është tërësisht e kapur nga politika dhe 25.5% mendojnë se administrata publike është pjesërisht e kapur nga politika.
- 87% e të rinjve besojnë se paqëndrueshmëria në skenën politik prek thellësisht administratën publike dhe ndikon në krijimin e një gjendjeje paqëndrueshmërie e tranzicioni të vazhdueshëm, veçanërisht gjatë zgjedhjeve. Për më tepër, 78% e të rinjve mendojnë se ndërhyrjet apo influenca e vazhdueshme e politikës ndikojnë dukshëm në efikasitetin e administratës publike.
- Duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit politike dhe fryrjen e numrit të punonjësve në Administratën Publike, 68% e të rinjve besojnë se në pesë vitet e fundit politika ka shtrirë ndikimin e saj edhe më tepër në administratën publike.
- Të rinjtë mendojnë se tre mënyrat kryesore të punësimit në administratën publike ka janë të punësuar përmes lidhjeve politike (64% e të rinjve), korrupsionit (12.5%), nepotizmit (12%).
- Rreth 54% e të rinjve e kanë vlerësuar negativisht punën e bërë nga Departamenti Administratës Publike (DAP) në minimizim dhe shmangjen ndërhyrjeve politike dhe garantimin e të drejtave të barabarta në punësim.
- Sa i takon perceptimit që të rinjtë kanë për ndikimin e politikës në Administratën Publike në të ardhmen, 71% e të rinjve nuk besojnë se politika do ta ulë ndikimin e saj.
- 53% e të rinjtë janë shprehur se nuk do ta konsideronin anëtarësimin në një parti politike për të rritur mundësitë e tyre të punësimit në administratën publike, 25.5% e të rinjve ndoshta do ta konsideronin përfshirjen në një parti politike për të rritur shanset e tyre për punësim dhe 11.1% e të rinjve do ta konsideronin përfshirjen në një parti politike për të rritur shanset e tyre të punësimit në administratën publike.



5. Rekomandime

Në bazë të rezultateve të studimit që ka matur perceptimin e të rinjve mbi influencën e politikës në administratën publike, disa rekomandime që mund të merren në konsideratë janë:

- Perceptimi se ndërhyrjet politike e kanë prekur thellësisht administratën publike rezulton në përqindje të lartë në mesin e të rinjve. Perceptimi i të rinjve vjen si rrjedhojë e abuzimit të vazhdueshëm të pushtetit me administratën publike. Ndaj, për të ulur ndikimin e pushtetit mbi administratën publike është e nevojshme që qeveria të ndalojë kapjen e administratës dhe shfrytëzimit të saj në prag të çdo procesi zgjedhor.
- Krijimi i mekanizmave të pavarura dhe transparente për rekrutimin, promovimin dhe vendosjen e punonjësve në administratën publike, për të ndaluar influencën e politikës në këto procese.
- Është e nevojshme të bëhen përpjekje reale për të zvogëluar ndikimin e politikës, korrupsionin dhe nepotizmin në administratën publike. Ndërhyrjet dhe shfrytëzimi i administratës publike nga kasta politike cënon besueshmërinë dhe legjitimitetin e institucioneve në sytë e qytetarëve. Prandaj, është e rëndësishme që administrata publike të mbetet e pavarur dhe të mos jetë subjekt i ndërhyrjeve politike.
- Kriteret e qarta dhe të bazuara në meritë: Në vend të favorizimit të njerëzve të besuar politikisht, kualifikimi dhe meritat duhet të jenë kriteret kryesore për emërimin e zyrtarëve në administratën publike. Qeveria shqiptare duhet të zbatojë në praktikë kriteret dhe procedurat e punësimit, si dhe të sigurojë një qasje transparente për emërimin e zyrtarëve në administratën publike, veçanërisht në nivel drejtuesish.
- Departamenti i Administratës Publike duhet të bëjë më shumë përpjekje për të garantuar të drejta të barabarta në punësim dhe shmangur ndërhyrjet politike, dhe të mos shërbejë si një mekanizëm në dorën e pushtetit për të shtrirë influencën dhe përdorur punësimin në administratën publike për kapital politik.
- Emigrimi dhe dëshira e lartë për të emigruar e pjesës më të arsimuar të të rinjve shqiptarë janë simptomë e strukturave të kapura nga sistemi politik. Është i nevojshëm inkurajimi i të rinjve që të angazhohen në iniciativa qytetare, për të kontribuar dhe për të denoncuar me zë rastet e ndikimit të politikës në administratën publike.
- Është e nevojshme të përmirësohet ndërlidhja midis mekanizmave të monitorimit të administratës publike dhe të gjithë nivelit të qeverisë. Kjo do të ndihmojë në raportimin e shpejtë dhe të saktë të shkeljeve të rregullave dhe në ndjekjen e tyre.



6. Referenca

European Commission. (2022). Albania 2022 Report.

Aksesuar në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

European Commission. (2018). A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, p. 4.

Aksesuar në: communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

Dhëmbo.E. (2014). Shqiptarët dhe Modeli Social Evropian. Administrata Publike në Shqipëri Midis Politikës dhe Qytetarit.

Aksesuar në: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/11312.pdf>

Semini.I & Korçari.I. (2022). Sondazh i opinionit publik 2021: Besimi në qeverisje. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

Aksesuar në: <https://idmalbania.org/public-opinion-poll-trust-in-governance-2021/>

Çela.A & Kamberi.A. (2019). Fondacioni "Friedrich Ebert" (FES) Rinia Shqiptare 2018/2019. Aksesuar në: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf>

Hallunaj.M & Strati.N. (2023). Perceptimi publik ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, se dhe çështjeve të korrupsionit në Shqipëri. Anketa e WBSB në Shqipëri. Raporti i Shtetit 2023.

Aksesuar në: http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2023/01/WBSB-2022_Albania-Report-2_Jan-2023_ALB.pdf

King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?

Aksesuar në: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17258.pdf>



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al